



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 18 shkurt 2022  
Nr.ref.: RK 1948/22

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI28/21**

Parashtrues

**Xhemë Nuredini**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të  
Kosovës ARJ-UZVP.nr.87/2020 të 17 dhjetorit 2020**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Xhemë Nuredini (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) nga fshati Smirë, komuna e Vitisë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme ARJ-UZVP.nr.87/2020 të 17 dhjetorit 2020.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (1) [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (1) dhe (7) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 8 shkurt 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 11 shkurt 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
7. Më 16 shkurt 2021, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 2 shkurt 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhje e fakteve**

9. Nga dokumentet e dorëzuara rrjedh se parashtruesi i kërkesës që nga viti 2006 kishte qenë i punësuar në pozitën e Zyrtarit Juridik në Agjencionin Pyjor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: APK). Detyrat dhe përgjegjësitë e parashtruesit të kërkesës kanë qenë përfaqësimi i APK-së pranë organeve gjyqësore dhe administrative si dhe punë tjera të autorizuara nga drejtori i APK-së.

10. Më 18 tetor 2012, Prokuroria Komunale në Ferizaj me propozim-akuzën PP.nr.1404-06/12 kishte ngarkuar parashtruesin e kërkesës me kryerje të veprës penale shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit nga neni 339 par.1 i KPK-së dhe për shkak të veprës penale dhënia e kundërligjshme e ndihmës juridike nga neni 336 par.1 i KPK-së.
11. Ndërkohë, më 31 tetor 2012, Komisioni Disiplinor i APK-së kishte shqiptuar kundër parashtruesit të kërkesës masën ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil të APK-së.
12. Më 19 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa të APK-së duke pretenduar se Komisioni Disiplinor i APK-së nuk ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike.
13. Më 13 dhjetor 2012, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa të APK-së e refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës ndërsa e vërtetoi vendimin e Komisionit Disiplinor të APK-së.
14. Më 28 dhjetor 2012, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPMK) kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të APK-së duke pretenduar se njëjti është i padrejtë dhe i pabazuar. KPMK-ja pas shqyrtimit të ankesës së parashtruesit të kërkesës nxjerrë vendim për pezullim të procedurës administrative derisa të vendosë Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda.
15. Më 14 prill 2014, Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda përmes Aktgjykimit P.nr.1516/12 konform nenit 364 par.1 të KPPK-së e liroi parashtruesin e kërkesës nga akuza që e rëndonte sepse nuk ishte provuar se i njëjti ka kryer veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit nga neni 339 par.1 i KPK-së.
16. Më 15 janar 2015, parashtruesi i kërkesës paraqet ankesë-kërkesë në KPMK për riaktivizimin e ankesës së 28 dhjetorit 2012.
17. Më 13 mars 2015, KPMK-ja përmes Vendimit A 02/16/2015 obligon Komisionin Disiplinor të APK-së që të ndërmerr të gjitha veprimet procedurale-ligjore për shqyrtim të ankesës së parashtruesit të kërkesës.
18. Më 27 mars 2015, Komisioni Disiplinor i APK-së përmes Vendimit nr. 084/2015 e ndërpre në marrëdhënien e punës së parashtruesit të kërkesës.
19. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të APK-së.
20. Më 19 maj 2015, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të APK-së përmes vendimit me numër protokolli Ref. SBNJD-141/15 e refuzon ankesën

dhe e vërteton vendimin e kontestuar të Komisionit Disiplinor të APK-së të 27 marsit 2015.

21. Më 29 maj 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në KPMK kundër vendimit të lartpërmendur të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të APK-së.
22. Më 22 korrik 2015, KPMK-ja përmes Vendimit A 02/277/2015 përcaktoi: **(i) REFUZOHET** e pabazuar ankesa nr. A 02/277/2015 e datës 29.05.2015, e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës; **(ii) MBETET në fuqi** Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i APK-së, me numër protokolli Ref. SBNJD-141/15 i datës 19.05.2015; **(iii)** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.
23. KPMK-ja konstatoi: **(i)** Kolegji për shqyrtimin e ankesave, shqyrtoi pretendimin ankimor të parashtruesit të kërkesës që pretendon se Komisioni Disiplinor i APK-së me Vendimin me ref. SBNJD-084/2015 të datës 27.03.2015 ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës për çështjen me të cilën është liruar si i pafajshëm sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda P. nr. 1516/12 të datës 14.04.2014 e i cili me datë 19.11.2014 ka marrë formën e prerë; **(ii)** Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i parashtruesit të kërkesës është i pabazuar, sepse nuk është kontestuese se me Aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Ferizaj- Departamenti për Krime të Rënda P. nr. 1516/12 i datës 14.04.2014, parashtruesit i kërkesës është shpallur i pafajshëm, por Komisioni Disiplinor ka konstatuar se parashtruesit të kërkesës i është ndërprerë marrëdhënia e punës sepse janë edhe tetë (8) dëshmi-prova të cilat përbëjnë shkelje të rënda disiplinore e të cilat nuk kanë qenë objekt i shqyrtimit për Gjykatën Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda; **(iii)** Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor ka konstatuar se parashtruesi i kërkesës është përgjegjës sepse në vendin e tij të punës ka hartuar ankesa, kundërshtime në vendimet gjyqësore, në dobi të palëve të dënuara për prerje dhe dëmtime ilegale të pyjeve, të cilat palë kanë qenë të paditura nga APK-ja dhe Autoriteti Pyjor Komunal; **(iv)** me këtë veprim, parashtruesi i kërkesës ka kryer shkelje të rëndë-serioze të detyrave të punës, të përcaktuara me nenin 6 nën-paragrafin 1.1, 1.7 dhe 1.15 të Rregullores për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil Nr. 04/2011; **(v)** KPMK-ja kishte numëruar e paraqitur të tetë (8) ankesat, kundërshtimet, prapësimet që i kishte shkruar parashtruesi i kërkesës gjatë periudhës 2008 deri 2011, të cilat ishin paraprakisht në procedurë disiplinore ishin shqyrtuar nga Komisioni Disiplinor dhe Komisioni për Shqyrtim të Kontesteve dhe Ankesave të APK-së.
24. Më 25 gusht 2015, parashtruesi i kërkesës e kontestoi vendimin e lartpërmendur të KPMK-së në Gjykatën Themelore në Prishtinë duke pretenduar se është i kundërligjshëm, që kërkesëpadia të aprovohet dhe vendimi i kontestuar i KPMK-së të anulohet.
25. Më 9 nëntor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktgjykimit A.nr.1511/15 e refuzoi të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës me çka kishte kërkuar që të anulohet Vendimi i KPMK-së A 02/277/2015 i 22

korrikut 2015. Gjykata Themelore konstatoi: **(i)** KPMK-ja ka analizuar shqyrtimet e parashtruesit të kërkesës dhe ka konstatuar se vendimi i Komisionit Disiplinor të APK-së është i drejtë pasi që nuk është kontestuese se me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Ferizaj p.nr.1516/12 të 14 prillit 2014 parashtruesi i kërkesës shpallet; **(ii)** mirëpo Komisioni Disiplinor i APK-së ka konstatuar se parashtruesit të kërkesës i është ndërprerë marrëdhënia e punës sepse janë edhe tetë (8) dëshmi-prova të cilat përbëjnë shkelje të rënda disiplinore e të cilat nuk kanë qenë objekt i shqyrtimit për Gjykatën Themelore në Ferizaj; **(iii)** prandaj, Vendimi i KPMK-së është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se parashtruesit të kërkesës nuk i është cenuar ndonjë e drejtë ligjore.

26. Më 10 janar 2018, parashtruesi i kërkesës e kontestoi aktgjykimin e lartpërmendur në Gjykatën e Apelit duke pretenduar vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me kërkesë që aktgjykimi i kontestuar të anulohet dhe që ai të kthehet në vendin e punës me të gjitha të drejtat që i takojnë sipas ligjit.
27. Më 17 tetor 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit AA.nr.54/2018 aprovoi të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës të 10 janarit 2018 ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore A.nr.1511/15 i 9 nëntorit 2017 prishet dhe lënda kthehet në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Apelit konstatoi: **(i)** aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore procedurale në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LPK-së; **(ii)** gjykata e shkallës së parë nuk e shqyrtuar vendimin e organit të paditur se a është përmbajtjesor në pajtim me dispozitat e LKA-së; **(iii)** aktgjykimi i ankimuar është juridikisht i paqartë lidhur me përmbledhjen vendimtare të fakteve sepse nuk janë shqyrtuar në tërësi pretendimet e parashtruesit të kërkesës; **(iv)** prandaj, gjykata e shkallës së parë në rigjykim duhet të eliminojë shkeljet procedurale dhe të shqyrtojë në tërësi pretendimet e parashtruesit të kërkesës në pajtim me dispozitat përkatëse të LKA-së dhe LPK-së si ligj i zbatueshëm në këtë çështje.
28. Më 14 janar 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktgjykimit A.nr.2860/18 e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës me të cilën kishte kërkuar anulimin e Vendimit të KPMK-së nr. A 02/277/2015 të 2 korrikut 2015 të pabazuar. Gjykata Themelore konstatoi: **(i)** KPMK-ja ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar sepse nuk është kontestuese se në aktgjykimin e formës së prerë parashtruesi i kërkesës është shpallur i pafajshëm, mirëpo KPMK-ja ka konstatuar se parashtruesit të kërkesës i është ndërprerë marrëdhënia e punës sepse janë edhe tetë (8) prova që përbëjnë shkelje të rënda disiplinore të cilat nuk kanë qenë objekt shqyrtimi i gjykatës penale; **(ii)** konform dispozitave të nenit 44 (1) të ligjit për konfliktet administrative vlerësoi ligjshmërinë vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjeve në padi, shkresave të lëndës në këtë çështje administrative dhe ka konstatuar se kërkesëpadia është e pabazuar; **(iii)** organi i punësimit APK ka vërtetuar gjendjen faktike duke marrë për bazë deklaratat e dhëna nga vet parashtruesi i kërkesës dhe palët e treta; **(iv)** parashtruesi i kërkesës është ballafaquar me shkeljet e konstatuara që kanë të bëjnë me përpilimin e ankesave për personat e tretë, të cilat fakte nuk i ka kontestuar; **(v)** Komisioni i

Ankesave i AKP-së ka marrë për bazë provat që nuk kanë qenë objekt shqyrtimi në procedurën penale; **(vi)** Komisioni i Ankesave i AKP-së i ka konsideruar veprimet e parashtruesit të kërkesës shkelje të rënda të punës nga neni 3, 4, 7, 15 të Kodit të Mirësjelljes dhe neni 6 të Rregullores për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil të Kosovës Nr.04/2011; **(vii)** bazuar në të lartcekurat, në kuptim me dispozitat përkatëse të ligjit për konfliktet administrative, refuzohet kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

29. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të procedurës kontestimore dhe vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike me propozim: **(i)** që ankesa e tij të aprovohet; **(ii)** vendimin e Komisionit Disiplinor nr.084/2015 të 27 marsit 2015, vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, vendimin e KPMPK-së nr. A 02/277/2015 të 22 korrikut 2015, aktgjykimin e Gjykatës Themelore A.nr.2860/18 të 14 janarit 2019, t'i anuloj dhe parashtruesin e kërkesës ta kthej në vendin e punës me të gjitha të drejtat ligjore që i takojnë sipas ligjit.
30. Më 8 tetor 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit AA.nr.271/2019 e refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës të 4 marsit 2019, ndërsa Aktgjykimin e Gjykata Themelore në Prishtinë A.nr.2860/18 të 14 janarit 2019, e vërtetoi. Gjykata e Apelit vlerësoi: **(i)** aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as me shkelje tjera që do të ndikonin në ligjshmërinë e tij; **(ii)** sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë prova të mjaftueshme që vërtetojnë se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë të pabazuara; **(iii)** pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga organi i paditur dhe në kundërshtim me shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi; **(iv)** bazuar në dispozitat përkatëse të LKA-së dhe LPK-ë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
31. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme duke kontestuar ligjshmërinë e aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit. Parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se aktgjykimi i goditur është rrjedhojë se shkeljes së të drejtës materiale dhe dispozitave procedurale duke propozuar që çështja të kthehet për rigjykim në Gjykatën e Apelit ose që Gjykata Supreme të vendosë në mënyrë meritore.
32. Më 17 dhjetor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit ARJ-UVZP.nr.87/2020 e refuzoi të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, parashtruar kundër Aktgjykimit Gjykata e Apelit AA.nr.271/2019 të 8 tetor 2020. Gjykata Supreme konstatoi: **(i)** gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë vërtetuar se vendimi i kontestuar nga parashtruesi i kërkesës është i drejtë dhe ligjërish i bazuar sepse organi administrativ drejtë ka zbatuar dispozitat përkatëse të LKA-së, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka refuzuar padinë e parashtruesit të kërkesës; **(ii)** nga faktet e vërtetuara në

procedurë administrative, gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë konstatuar se pala e paditur APK ku parashtruesi ka punuar zyrtar për çështje juridike, drejtë ka vërtetuar se parashtruesi i kërkesës ka kryer shkelje të rënda disiplinore duke marrë për bazë deklaratat e vetë parashtruesit të kërkesës dhe të palëve tjera që janë dëgjuar në procedurë disiplinore; **(iii)** shkeljet e konstatuara kanë të bëjnë me përpilimin e paligjshëm të ankesave për palët e treta; **(iv)** bazuar në dispozitat përkatëse të LKA-së është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.
34. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] posaçërisht shkelja e Nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me Nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së. Mos zbatim i vendimit gjyqësor të Gjykatës themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda P.nr.1516/12. Aktgjykim i plotfuqishëm i kësaj gjykate.”*
35. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon: *“kam pasur mundësinë e mjetit juridik-kallëzim penal për mos zbatim të vendimit gjyqësor nga ana e KPMSHCK-së por nuk kam mundur ta bëj për shkak të kërcënimit nga Kryeshefi i Agjencionit Pyjor (APK) A.Z.”*
36. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata *“që të vlerësojë drejtë pretendimet e tij dhe aktgjykimet t'i prishë dhe çështjen ta kthej në rigjykim.”*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

37. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
38. Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

39. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashikojnë:

*Neni 47  
[Kërkesa individuale]*

*“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

*Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]*

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

*Neni 49  
[Afatet]*

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”*

40. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar se konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [UVZP.nr.87/2020] të 17 dhjetorit 2020, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
41. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikon:
- “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
42. Gjykata rikujton që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së si dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë



kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme në bazë të dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KIO4/21, parashtruese *Nexhmije Makolli*, aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin KI175/21, parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

43. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “*qartazi e pabazuar*” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuzë dhe të paqarta*”. (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “*qartazi të pabazuar*”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “*qartazi të pabazuara*”, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 31 gushtit 2019; Pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284, shih gjithashtu rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27, si dhe rastin KI175/21, cituar më lart, paragrafi 38).
44. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28).
45. Gjykata përsëritë se esenca e këtij rasti është se parashtruesi i kërkesës që nga viti 2006 kishte qenë i punësuar në pozitën e Zyrtarit Juridik në APK. Komisioni Disiplinor dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të APK-së kishin nxjerrë dhe miratuar vendim për ndërprerje të marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës nën akuzën se ai në mënyrë të kundërligjshme kishte përpiluar ankesa dhe parashtrësia për palët tjera në procedura gjyqësore kundër APK-së. Çështja e parashtruesit të kërkesës kishte kaluar në një proces të ndërlidhur administrativ dhe gjyqësor që në fund kishin përfunduar me miratimin e vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës të parashtruesit të kërkesës nga KPMK-ja Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.

46. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda e kishte liruar atë nga akuza që e rëndonte për shpërdorim të pozitës zyrtare dhe se për këtë shkak ai duhet të kthehet në vendin e punës me të gjitha të drejtat që ia akordon ligji. Parashtruesi i kërkesës shton se mos kthimi i tij në vendin e punës ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.
47. Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata përsëritë konstatimet e Gjykatës Themelore: **(i)** KPMK-ja ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar sepse nuk është kontestuese se në aktgjykimin e formës së prerë parashtruesi i kërkesës është shpallur i pafajshëm, mirëpo KPMK-ja ka konstatuar se parashtruesit të kërkesës i është ndërprerë marrëdhënia e punës sepse janë edhe tetë (8) prova-dëshmi që përbëjnë shkelje të rënda disiplinore të cilat nuk kanë qenë objekt shqyrtimi i gjykatës penale; **(ii)** konform dispozitave të nenit 44 (1) të ligjit për konfliktet administrative vlerësoi ligjshmërinë vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjeve në padi, shkresave të lëndës në këtë çështje administrative dhe ka konstatuar se kërkesëpadia është e pabazuar; **(iii)** organi i punësimit APK ka vërtetuar gjendjen faktike duke marrë për bazë deklaratat e dhëna nga vet parashtruesi i kërkesës dhe palët e treta; **(iv)** parashtruesi i kërkesës është ballafaquar me shkeljet e konstatuara që kanë të bëjnë me përpilimin e ankesave për personat e tretë, të cilat fakte nuk i ka kontestuar; **(v)** Komisioni i Ankesave i AKP-së ka marrë për bazë provat që nuk kanë qenë objekt shqyrtimi në procedurën penale; **(vi)** Komisioni i Ankesave i AKP-së i ka konsideruar veprimet e parashtruesit të kërkesës shkelje të rënda të punës nga neni 3, 4, 7, 15 të Kodit të Mirësjelljes dhe neni 6 të Rregullores për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil të Kosovës Nr.04/2011.
48. Gjykata po ashtu vë në spikamë konstatimet e Gjykatës Supreme: **(i)** gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë vërtetuar se vendimi i kontestuar nga parashtruesi i kërkesës është i drejtë dhe ligjërish i bazuar sepse organi administrativ drejtë ka zbatuar dispozitat përkatëse të LKA-së, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka refuzuar padinë e parashtruesit të kërkesës; **(ii)** nga faktet e vërtetuara në procedurë administrative, gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë konstatuar se pala e paditur APK ku parashtruesi ka punuar zyrtar për çështje juridike, drejtë ka vërtetuar se parashtruesi i kërkesës ka kryer shkelje të rënda disiplinore duke marrë për bazë deklaratat e vetë parashtruesit të kërkesës dhe të palëve tjera që janë dëgjuar në procedurë disiplinore; **(iii)** shkeljet e konstatuara kanë të bëjnë me përpilimin e paligjshëm të ankesave për palët e treta; **(iv)** bazuar në dispozitat përkatëse të LKA-së është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
49. Gjykata vlerëson se pretendimi i parashtruesit të kërkesës se KPMK-ja dhe gjykatat e rregullta nuk kanë marrë për bazë Aktgjykimin lirues-shfajësues të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda është i paqëndrueshëm sepse janë edhe tetë (8) prova tjera që vërtetojnë se

parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare të cilat nuk kanë qenë objekt shqyrtimi i gjykatës penale.

50. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda kishte shqyrtuar këto prova: **(i)** Kundërshtim ndaj aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj P.nr.191/10 i datës 18.07.2011; **(ii)** Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj P.nr.191/10 i datës 18.07.2011; **(iii)** Aktvendim i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje Nr.15115/2011 i datës 10.01.2011.
51. Tetë (8) provat-dëshmitë tjera që nuk kanë qenë objekt shqyrtimi i gjykatës penale por që kanë qenë objekt shqyrtimi në procedurë disiplinore-administrative në Komisionin Disiplinor dhe Komisionin e Ankesave të APK-së që më vonë janë vërtetuar edhe nga KPMK-ja dhe gjykatat e rregullta janë: **(i)** Ankesë Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Ferizaj për Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë kundër aktvendimeve të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje Ri 6150,12004,6103/2011; **(ii)** Prapsim Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Ferizaj kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj RI.nr. 13203 i datës 16.10.2009; **(iii)** Ankesë për Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale në Kaçanik P.nr. 123 i datës 23.11.2008; **(iv)** Ankesa Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Kaçanik P.nr. 268 i datës 11.11.2011; **(v)** Ankesë për Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj P.nr. 480/06 i datës 10.11.2011, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj P.nr. 480/06; **(vi)** Ankesa për Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Kaçanik P.nr. 228/07 i datës 15.04.2011; **(vii)** Ankesa për Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Shtërpçë P.nr. 5/10 i datës 18.08.2010; dhe **(viii)** Kundërshtim kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj p.nr. 191/2010 të datës 18.07.2011.
52. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se është evidente që provat që janë përdorë në procesin disiplinor-gjyqësor kundër parashtruesit të kërkesës nuk kanë qenë objekt shqyrtimi në procesin penal. Shqyrtimi i tetë (8) provave nuk ngre çështje të parregullsisë së procesit disiplinor-gjyqësor apo të ndalimit të ushtrimit të profesionit sepse kjo më shumë është çështje e diskrecionit në gjykim të KPMK-së dhe të gjykatave të rregullta çka Gjykata duhet ta respektojë bazuar në karakterin subsidiar të kërkesës individuale kushtetuese.
53. Veç kësaj, Gjykata po ashtu vëren se gjatë zhvillimit të procesit disiplinor-gjyqësor kundër parashtruesit të kërkesës KPMK-ja dhe Gjykata e Apelit e kthyen çështjen në rigjykim tek Komisioni Disiplinor i APK-së përkatësisht Gjykata Themelore, çka është tregues i seriozitetit në gjykim dhe eliminimit të parregullsive të procesit disiplinor-gjyqësor.
54. Në lidhje me këtë, Gjykata duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se

- janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, parashtrues: *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 07 nëntorit 2019, paragrafi 40).
55. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih: në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 56; dhe KI62/19, cituar më lart, paragrafi 58).
  56. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës përfitoi nga procedura kontradiktore dhe se ai ishte në gjendje të paraqes në faza të ndryshme të procedurës pretendimet dhe provat që ai i konsideroi të rëndësishme për rastin e tij; ai ka pasur mundësinë të hedh poshtë në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta dëgjuan dhe shqyrtuan të gjitha pretendimet e tij, të cilat, shikuar objektivisht, ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit; arsyet faktike dhe ligjore për vendimet e kontestuara janë dhënë në hollësi dhe procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih: *mutatis mutandis*, aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30, shih gjithashtu rastin KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rasti KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).
  57. Në rrethanat e këtij rasti, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimeve për shkelje të neneve 31, 49, 53 dhe 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i vërtetimit të gabuar të fakteve dhe interpretimit të gabuar të ligjit, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë “*qartazi i gabuar*”, duke rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës apo se procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kanë arsyetuar të njëjtat (Shih: në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI64/20, parashtruesi i kërkesës: *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41, dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
  58. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje neneve 31, 49, 53 dhe 55 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe

interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm janë (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 2 shkurt 2022, njëzëri

### VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

  
Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Gresa Caka-Nimani